



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 27 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-194, nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenit 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 03 korrik 2023 vazhdim i mbledhjes së datës 29 qershor 2023, miratoi këtë;

VENDIM

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS NGA VITI 2022 NË VITIN 2023 DHE DESTINIMIN NË KATEGORI DHE PROGRAME TË CAKTUARA BUXHETORE

Neni 1

1. Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës, të pashpenzuara në vitin 2022 nga fondi 22, në shumën e gjithmbarshme 151,443.9 €, barten në vitin 2023, dhe atë në programet dhe kategoritë ekonomike si në vijim:

Programi:

- Administratë Komunale.....151,443.9 €

Kategoria ekonomike:

- Investime kapitale.....151,443.9 €

2. Mjetet e cekura sipas këtij neni, destinohen në kategoritë e caktuara ekonomike sipas specifikacionit i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 3

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-400/03-0045353/23
Podujevë, datë: 03 korrik 2023



**Specifikacioni i projekteve të financuara nga mjetet vetanake
të bartura nga viti 2022 në vitin 2023**

II - Programi - Infrastruktura Publike -18165

kodi funksional-00451

Kodi i projektit	kodi ekor	Përshkrimi	Shuma
40280	30	Ndërtimi i stacionit të udhëtarve	151,443.90
		Totali	151,443.90

Kategorit ekonomike	Shuma
Paga	
Mallra e Shërbime	
Subvencione	
Investime Kapitale	151,443.90
Gjithsejt të hyrat e bartura nga viti - 2022 :	151,443.90

